



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Morfologji A (Morfologji e Gjuhës Shqipe)**

Ngarkesa: 4kredite; 40 orë mësimore; (20 + 20)

Viti / Semestri: Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Angleze

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore

Kjo lëndë synon pajisjen e studentëve me njohuri teorike dhe praktike rreth fjalës, strukturës së saj morfologjike, duke mundësuar analiza morfemore dhe fjalëformuese. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj lënde studentët marrin njohuri për pjesët e ligjëratës, për klasifikimin e tyre sipas kriterëve të ndryshme, të formës, kuptimit, funksionit, prejardhjes dhe ndërtimit, për kategoritë leksiko-gramatikore, paradigmën përkatëse, si dhe për proceset fjalëformuese në gjuhën shqipe.

Objektivat specifike lëndor:

1. Studentët aftësohen në dallimin e pjesëve të ndryshme të ligjëratës dhe të kategorive leksiko-gramatikore përkatëse si dhe në analizën e tyre sipas këtyre kategorive.
2. Studentët pajisen gjithashtu me njohuri nga modelet fjalëformuese të gjuhës shqipe, duke i aftësuar për analiza morfemore dhe fjalëformuese dhe për pasurimin e shqipes me fjalë mbështetur në brumin e saj, sipas modeleve aktive dhe prodhimtare fjalëformuese